


REVISTA VJETORE

SINDIKATA E PUNONJESVE
TE POSTE-TELEKOMIT SHQIPTAR




2017-2018



Kongresi i 7-të i Sindikatës së Punonjësve Postë - Telekom

10 Shkurt 2017



SINDIKATA E PUNONJËSVE TË POST-TELEKOMIT SHQIPTAR (SPPTSH)

SPPTSH është një organizatë sindikale sektoriale në të cilën aderohet kryesisht punonjësit e telekomunikacionit, shërbimeve postare dhe është e hapur për të gjithë individët, sektorët privat dhe publik që i përkasin këtyre fushave apo profesioneve të tjera, si dhe sindikata të profesioneve që dëshirojnë anëtarësimin në këtë Sindikatë.

Themelimi i Sindikatës së bashkuar të PTT në të gjithë Shqipërinë u vendos në shkurt të vitit 1991, ku dy Sindikata ajo e Uzinës PTT dhe PTT Tirana mbajtën Kongresin e Parë. Nga ky kongres u zgjodhën edhe drejtuesit e parë të SPPTSH-së dhe kryetare u zgjodh znj. Rajmonda Paçuka, zv/kryetar. z. Shpëtim Vojka dhe sekretar z. Aleksandër Miraj. Që nga themelimi i saj, kjo sindikatë ka pasur si qëllim të bashkojë dhe të organizojë punonjësit, pavarësisht nga përkatësia e tyre politike, etnia, raca, profesioni, gjinia apo bindjet fetare.

Në vazhdim Sindikata është drejtuar nga të zgjedhurit në Kongreset që ajo ka organizuar.

Më poshtë po listojmë kongreset dhe kryetarët e zgjedhur ndër vite:

- » Kongresi II 1995 – znj. Rajmonda Paçuka
- » Kongresi III 2001- z. Aleksandër Miraj
- » Kongresi IV 2005 – z. Shpëtim Vojka
- » Kongresi V 2009 – z. Shpëtim Vojka
- » Kongresi VI 2014 – z. Renato Muçaj
- » Kongresi VII 2017 – z. Renato Muçaj

SPPTSH është një organizatë e ngritur nga aderimi mbi baza vullnetare të punonjësve, dhe ka si mision të mbrojë dhe promovojë interesat e anëtarëve të saj, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar të punës dhe të drejtat e njeriut. Sot, SPPTSH rregullon marrëdhëniet midis punëdhënësit dhe punonjësve të punësuar në Albtelecom, Makhes dhe Postën Shqiptare.

SPPTSH është e organizuar në të gjithë Shqipërinë me disa qendra rajonale. SPPTSH është anëtare në Federatën Ndërkombëtare të Sindikatave, UNI GLOBAL, e cila është ndër ato më të mëdha dhe përfaqëson 20 milion punonjës, nga 900 sindikata në 140 vende të ndryshme.

KRYETARI I SINDIKATËS SË PUNONJËSVE TË POSTE-TELEKOMIT SHQIPTAR



Të nderuar kolegë, sindikalistë të SPPTSH-së,

Më lejoni që në këtë vit të tretë të botimit të revistës sonë vjetore ku përmbledhen aktivitetet kryesore të sindikatës gjatë një viti, t'ju drejtohem me një falenderim të sinqertë të gjithë anëtarëve të sindikatës sonë. Një falenderim dhe vlerësim u takon të gjithë kolegëve të strukturave të SPPTSH-së, që kanë punuar me seriozitet për të përfaqësuar denjësisht të gjithë punonjësit e seksioneve dhe rajoneve të tyre edhe të gjithë partnerëve kombëtar dhe ndërkombëtar që na kanë mbështetur në veprimtarinë tonë sindikaliste, por edhe moralisht për punën që kemi bërë deri tani, përballjen me sfidat që kemi kaluar edhe ato që na presin.

Viti 2017 ishte një vit shumë i rëndësishëm pasi në 10 Shkurt 2017, sindikata mbajti kongresin e saj të VII-të. Ky kongres ishte një zhvillim i rëndësishëm jo vetëm prej faktit se ishte një organizim model i cili duhet të merret si një shembull dhe nga sindikatat e tjera në Shqipëri, as nga fakti se aty merrnin pjesë përfaqësues të lartë të qeverisë, Ministri i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, z. Blendi Klosi, përfaqësues të kompanive Albtelecom, Makhes, dhe përfaqësues të organizatave të tjera si motra, por për vendimet e rëndësishme që u morën në këtë kongres nga të gjithë delegatët e mandatuar dhe për mesazhet që u përcollën për të gjithë punonjësit. Një nga vendimet kryesore ishte ndryshimi i strategjisë së sindikatës për ti grupuar të gjithë kompanitë e sektorit të postave dhe telekomunikacionit nën Sindikatën e Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar. Ndryshimet statutore të miratuara i mundësojnë sindikatës që tashmë mos të jetë e hapur vetëm për kompanitë e sektorit por të jetë e hapur për të gjithë individët, sektorët privat dhe publik që i përkasin këtyre fushave që dëshirojnë anëtarësimin në këtë Sindikatë.

Si drejtues i SPPTSH-së, jam shumë i lumtur që dhe nga qeveria Shqiptare kemi arritur të marrim vlerësime për punën e kryer në sektorin e telekomunikacionit. Ashtu si dhe gjatë aktivitetit tonë të 25 Vjetorit, ku ministrja e Inovacionit znj. Milena Harito përcolli falenderimet e saj si dhe mesazhin që sindikata jonë të përfaqësoj edhe kompanitë e tjera të sektorit të telekomunikacionit. Njëkohësisht edhe në Kongresin e VII-të një tjetër përfaqësues i qeverisë Shqiptare, Ministri i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, z. Blendi Klosi përveç falenderimit bëri dhe një urim të vecantë për strukturat e SPPTSH-së, duke uruar produkte të vërteta dhe që fryma sindikaliste e sindikatës tonë të shërbej jo vetëm për të mbrojtur interesat e anëtarëve të sindikatës, por dhe si model i sindikatave të ngjashme në vendin tonë.

Në 27 Maj 2017, sindikata zhvilloi mbledhjen e parë të Këshillit Kombëtar të SPPTSH-së të dalë nga Kongresi i VII-të. Në mbledhjen e parë të tij, u zgjodhën strukturat e tjera drejtuese të SPPTSH-së, dhe u miratua plani strategjik për implementimin e strategjisë së zgjerimit të sindikatës në nivel sektorial vendosur në Kongresin e VII-të. Planin strategjik filloi të zbatohet këtë vit me disa kompani në sektorin e telekomunikacionit, postar dhe call center. Me të gjithë punonjësit e këtyre kompanive po punohet për sensibilizimin dhe antarësimin e tyre në sindikatë në mënyrë që SPPTSH ti përfaqësoj pranë punëdhënësit të tyre për lidhjen e kontratës kolektive.

Një rëndësi të veçantë i është kushtuar këtë vit strategjisë së re për zgjerimin e sindikatës në nivel sektorial, ku janë organizuar disa seminare trajnuese me partnerët tanë ndërkombëtar si Solidarity Center dhe UNIGlobal Union. Një zhvillim i rëndësishëm këtë vit ka qenë edhe partneriteti që ka nisur me sindikatën Gjermane Ver.di e cila është një nga sindikatat më të mëdha në Europë ku aderojnë 2 milion anëtarë. Ver.di është duke asistuar sindikatën tonë në kuadër të aleancës së Deutsche Telekomit për organizimin e sindikatës në Telekom Albania. Ky bashkëpunim ka sjellë takime reciproke ku është hartuar një protokoll pune për të përcaktuar qartë angazhimin e secilës palë në këtë partneritet strategjik.

2017-ta, ka qenë një vit i mbushur me një numër të lartë aktiviteteve sindikale. Në kuadër të strategjisë së re, janë zhvilluar një seri trajnimesh për përfaqësuesit e sindikatës. Por risia këtë vit ka qenë edukimi i anëtarësisë në të gjitha seksionet dhe rajonet, duke filluar me seksionet e Tiranës dhe duke vazhduar me rradhë me rajonin Shkoder-Lezhe, Kukes-Peshkopi, Korce-Elbasan, Fier-Berat dhe Vlore-Gjirokaster. Programet dhe trajnimi janë zhvilluar në bashkëpunim me fondacionin gjerman Friedrich Ebert Stiftung (FES), ku synimi ka qenë forcimi i sindikatës. Anëtarët nga baza sindikale të cilët kanë marrë pjesë kanë pasur mundësi që në fund të këtyre seminareve të diskutojnë me drejtuesit e sindikatës mbi problematikat në vendin e tyre të punës.

Të gjitha këto problematika të mbledhura i janë paraqitur drejtuesve të kompanive respektive. Një vendim tjetër i rëndësishëm këtë vit ka qenë përqëndrimi i aktiviteteve vetëm për anëtarët e sindikatës. Prandaj i është kushtuar një rëndësi e veçantë bashkëpunimeve me palë të treta në mënyrë që anëtarët të përfitojnë ulje në shërbime të ndryshme. Në prag të festave të fundvitit sindikata njoftoi të gjithë për përfitimet dhe uljet që çdo anëtarë mund të përfitonte në palestrën 24 orëshe Fit-Express, në dy klinikat dentare “Xholi” dhe në qendrën estetike “Flora”. Sindikata është duke mundësuar edhe bashkëpunime të tjera të cilat do tu bëhen të njohura anëtarëve gjatë vitit 2018. Në vazhdim të planit të miratuar nga Këshilli Kombëtar janë zhvilluar aktivitete social- kulturore për të vitalizuar anëtarësinë e SPPTSH-së për Seksionin Makhes 2. Për të gjithë anëtarët e këtij seksioni është organizuar një darkë festive me rastin e festave të fundvitit. Gjithashtu edhe këtë vit përsëri për të gjithë besimtarët myslimanë është shtruar darka e iftarit gjatë muajit të Ramazanit.

Jemi shumë të lumtur që falë kontratave kolektive të Sindikatës me punëdhënësit Altelecom dhe Makhes të gjithë punonjësit kanë përfituar një shpërblim me rastin e festave të fundvitit. Punonjësit e Kompanisë Makhes falë vendosjes së bazës minimale të shpërblimit të vitit të ri në Kontratën Kolektive kanë përfituar 5,000 lek. Ndërsa punonjësit e Altelecom kanë përfituar 25,000 lek. Një falenderim i veçantë shkon edhe për Drejtorin e Përgjithshëm të Altelecom që i është përgjigjur pozitivisht kërkesës së sindikatës për të motivuar punonjësit duke rritur shpërblimin e vitit të ri nga 20,000 lek në 25,000 lek.

Në revistën vjetore që botohet cdo muaj Shkurt, muaj që përkon dhe me themelimin e Sindikatës sonë në vitin 1991, do ti gjeni të gjitha këto aktivitete të detajuara në brendësi. Gjithsesi dua të theksoj edhe njëherë se puna jonë për të rritur dhe forcuar këtë sindikatë do të vazhdojë. Ne do të luftojmë për të ndërtuar një sindikatë moderne në shërbim të të gjithë anëtarëve. Sa më shumë solidarizohemi me sindikatën aq më shumë i shërbejmë zgjidhjeve të kauzave tona të përbashkëta.

KONGRESI I 7-TË I SPPTSH-së



Më datën 10 Shkurt 2017 në mjediset e Hotel Tirana International, zhvilloi me sukses punimet Kongresi Kombëtar i 7-të i Sindikatës së Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar. Në këtë Kongres ishin të ftuar përfaqësues të lartë të qeverisë, kompanive respektive, partnerëve të ndryshëm dhe delegacione të sindikatave simotra të huaja dhe të vendit. Në kongres merrnin pjesë rreth 200 anëtarë të SPPT-së si të ftuar dhe 85 delegatë nga të dyja kompanitë Altelecom dhe Makhes Albania.





Kongresi u hap me një klip të shkurtër prezantues, ku të gjithë të pranishmit patën mundësinë të shikojnë veprimtarinë e sindikatës që nga krijimi dhe vazhdimësinë e saj.

Mbas Himnit Kombëtar, kongresi u deklarua i hapur nga Sindikalisti më i vjetër z. Shpëtim Vojka. Mbas leximit të deklaratës së komisionit të verifikimit të mandateve për prezencën e delegatëve në Kongres, fjalën e mori Kryetari i Sindikatës z. Renato Mucaj për të mbajtur raportin e veprimtarisë së Kongresit.

Në fjalën e tij, z. Mucaj u ndal kryesisht në sfidat me të cilat ishte përballur sindikata në këto vite, punën e madhe që është bërë për të ndryshuar imazhin e sindikatës dhe për ta kthyer atë në funksion të anëtarëve të saj, mënyrën e zgjedhur nga sindikata për të arritur qëllimet e saj në zgjidhjen e problemeve dhe vizioni i sindikatës mbi të ardhmen për të përmirësuar kushtet social ekonomike të anëtarëve të saj.



Kryetari SPPTSH-së falenderoi gjithashtu të gjithë anëtarësinë e Sindikatës për besnikërinë e tyre dhe premtoi se kjo sindikatë do të vazhdojë punën e nisur për të qenë më pranë anëtarëve të saj. Gjithashtu, në mbyllje të raportit z. Mucaj falenderoi edhe partnerët dhe sindikatat e huaja që merrnin pjesë në punimet e Kongresit të SPPTSH-së. Më pas fjalën e morën me rradhë të gjithë të ftuarit të cilët përshëndetën Kongresin e 7-të të SPPTSH.



Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, z. Blendi Klosi në fjalën e tij falenderoi Sindikatën për ftesën, dhe vlerësoi maksimalisht punën e kryer nga kjo sindikatë gjatë këtyre viteve. Nga ky kongres ministri Klosi bëri me dije vendimin për rritjen e pagës minimale në vend, ndryshimet e fundit në kodin e punës, dhe përpjekjet e mëdha që po bëhen për ta shndërruar tregun e punës në Shqipëri një treg më konkurrues, një treg të punës së denjë dhe pagës së denjë për punonjësit shqiptarë.

‘Në javën në vazhdim ne do të kemi një vendim të Këshillit Kombëtar të Punës që është duke negociuar dhe dakortësuar me grupet sindikaliste dhe me grupet përfaqësues të punëdhënësve për rritjen e pagës minimale’- deklaroi ministri Klosi.

Gjithashtu ministri Klosi vuri theksin te roli që sindikatat duhet të luajnë gjatë dialogut social. Ai deklaroi: “Partneriteti social nuk është një slogan, ai është një progres i harmonizuar i interesave midis punëmarrësve dhe punëdhënësve, që nga niveli më i lartë në Këshillin Kombëtar të Punës deri në marrëdhëniet kolektive të cdo ndërmarrje. Në gjithë këtë proces roli i sindikatave është i pazëvendësueshëm. Gjithmonë ka patur një diskutim të gjatë në Shqipëri për rolin e sindikatave, por unë mendoj që kronikat e transmetuara edhe në hyrjen e këtij aktiviteti dëshmuar se sa të rëndësishme sindikatat kanë qënë në gjithë zhvillimet politike dhe administrative të vendit, se sa të rëndësishme janë dhe sot sindikatat dhe zëri i përbashkët i atyre njerëzve të cilët punojnë dhe jetojnë në këtë vend”.





Ministri Klosi e mbylli fjalën e tij në Kongresin e SPPTSH-së me urimin e mëposhtëm dhe kërkoi nga sindikata jonë që të jetë një shembull edhe për të tjerët:

“Prandaj të nderuar miqtë e mi, të nderuar përfaqësues të rinj dhe historik të kësaj sindikate, të nderuar sindikalist të ftuar nga sindikata simotra europiane, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale, për qeverinë shqiptare, raporti i bashkëbidesimit ndërmjet institucioneve shtetërore, punëdhënësve dhe punëmarrësve është në thelbin e politikave tona të punës, për punën e denjë, për pagesën e denjë, për jetën e denjë të gjithë atyre që punojnë në vendin tonë.

Unë ju uroj suksese Kongresit tuaj të 7-të, ju uroj produkte të vërteta dhe po ashtu ky kongres shërben që fryma sindikaliste e sindikatës tuaj të shërbej jo vetëm për të mbrojtur interesat e anëtarëve të sindikatës suaj, por dhe si model i sindikatave të ngjashme në vendin tonë.”



Më pas Kongresin e përshëndeti z. Giuseppe Farina, - Kryetari i Bordit Drejtues të Albtelecom sh.a.. Në emër të kompanisë Albtelecom, z.Farina vlerësoi marrëdhënien midis Sindikatës edhe Kompanisë dhe përpjekjet që bëhen për ti zgjidhur problemet me anë të dialogut social. Ai deklaroi gjithashtu orientimin e kompanisë për të zhvilluar më tej partneritetin social, jo vetëm me sindikatën por edhe me qeverinë, me të cilën Albtelecom sot ka rritur ndjeshëm bashkëpunimin në shumë fusha. Z. Farina u shpreh se Albtelecom është krenar që sot si një nga punëdhënësit më të mëdhenj në treg kërkon të rrisë akoma më shumë standartet e tij duke i kushtuar një rëndësi të vecantë punonjësve dhe dialogut social me sindikatën.





Më pas në emër të Sindikatës së Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar, kryetari z. Renato Mucaj i ka akorduar një Certifikatë Mirënjohje zëvendës ministres së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë znj. Vjollca Braho, për kontributin e dhënë në Sindikatë gjatë viteve që znj. Braho ka shërbyer në Albtelecom sh.a.



Znj. Braho mbasi falenderoi Sindikatën për certifikatën e dhënë, u shpreh njëkohësisht se ishte shumë e lumtur që sot në këtë Kongres ndihesh pjesë e punonjësve me të cilët kishte kaluar shumë vite gjatë punës në Albtelecom sh.a. Zëvendës ministrja Braho, shprehu mirënjohjen si për kompaninë Albtelecom ashtu edhe për brezat e vjetër që kanë kontribuar si në kompani ashtu edhe në sindikatën e punonjësve.



Kongresin e VII-të në pamundësi për të qenë pjesëmarrës e përshëndeti me anë të një video mesazhi Federata Ndërkombëtare UNIGlobal Union. Në mesazhin e tyre Drejtoresha e Departamentit të ICTS të UniGloblal Union znj. Alke Boessiger dhe koordinatori i programit të sindikatave z. Benjamin Parton përcollën edhe njëherë urimet më të përzemërta për SPPTSH, dhe konfirmuan mbështetjen e vazhdueshme që UNI kë dhënë dhe do të vazhdoj të jap në të ardhmen për SPPTSH.





Më pas kongresi vazhdoi me përshëndetjen e të gjithë delegacioneve të pranishme të cilët vlerësuan maksimalisht bashkëpunimin me Sindikatën e Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar:
ADO VILHELM – Përfaqësuesi i Sindikatës Gjermane Verdi





VASILIS LAMPROU

President i Sindikatës Greke të Telekomunikacionit OME-OTE



VELI SOLAK

President i Sindikatës Turke të Telekomunikacionit- HABER İŞ.



ANTONIS KLIRONOMAKIS

Sekretari i Sindikatës Greke të Postës



LAMIH BALAJ

President i Sindikatës së Kosovës Postë-Telekom FSP-PTK



JOHN ALOYSIUS HOSINSKI

Qendra e Solidaritetit, Konfederata Amerikane AFL-CIO



LAURENCE CLEMENTS

Qendra e Solidaritetit, Konfederata Amerikane AFL-CIO



HIQMETE DAJA
Presidente e Federatës së Tipografëve të Shqipërisë



ALDEINA LASKA
Drejtoreshë e Burimeve Njerëzore në Makhes Albania



FROSINA GJINO
Drejtuese e Qendrës AOSHC
(Albanian Occupational Safety & Health Center)



Në fund të seancës së parë të kongresit të 7-të, Sindikata akordoi disa certifikata mirënjohje për sindikalistë të vjetër, si dhe për Sindikatën Turke Haber- İŞ. Certifikata mirënjohje u akorduan për:

1) Vjollca Barci

2) Agim Sulaj

3) Shpëtim Vojka

4) Tatjana Millaqi

5) Vilma Tomco



Certifikatën e mirënjohjes për kontributet që ka dhënë sindikata turke për forcimin e SPPTSH-së e tërhoqi Presidenti i Sindikatës Turke të Telekomunikacionit - **HABER İŞ Z. VELI SOLAK** – i cili u shpreh shumë i emocionuar dhe mirënjohës për këtë vlerësim të ardhur nga Sindikata e Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar.





Në seancën e dytë Kongresi vazhdoi punimet me axhendën e mëposhtme:

- Zgjedhjen e Komisioneve të SPPTSH-së
- Ndryshimet dhe përmirësimet në Statutin e SPPTSH-së
- Zgjedhjen e Organeve Drejtuese dhe Kryetarin e SPPTSH-së

Gjatë kësaj seance komisioni votimit zhvilloi procedurën e votimit për Komisionet e Sindikatës në bazë të Statutit dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të SPPTSH-së.

Mbas zgjedhjeve të Komisioneve u kalua në votimin e Statutit të SPPTSH-së. Të gjithë delegatëve i ishte bërë më parë e ditur mbi ndryshimet e propozuara nga komisioni për përmirësimin e Statutit.

Ndryshimet Statutore të propozuara Kongresit u votuan dhe miratuan nga të gjithë delegatët e pranishëm. Më pas komisioni i votimit zhvilloi procedurën për votimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të cilët u miratuan nga Kongresi i 7 SPPTSH-së.





Në përfundim të këtyre procedurave u kalua në votimin e Kryetarit të SPPTSH-së. Komisioni i votimit bazuar në Statutin dhe në propozimin e Këshillit Kombëtar, deklaroi se është paraqitur vetëm kandidatura e z. Renato Mucaj për Kryetar të SPPTSH-së. Kryetari i Komisionit z. Armando Jaupi mbasi pyeti sekretariatën nëse është paraqitur ndonjë kandidaturë tjetër, ku rezultoi se nuk ka pasur asnjë propozim gjatë Kongresit të 7-të nga delegatët, hodhi për miratim mënyrën e votimit të Kryetarit të ri duke qenë se nuk është paraqitur kandidaturë tjetër. Të gjithë delegatët votuan për të proceduar me votim të hapur duke qenë se nuk ka një kandidaturë të dytë. Komisioni i votimit hodhi në votim të hapur kandidaturën e z. Mucaj, ku të gjithë delegatët votuan pro kandidaturës së z. Mucaj. Me mbylljen e procedurës së votimit, z. Mucaj bëri betimin dhe mbajti fjalën përshëndetëse përpara delegatëve. Z. Mucaj duke falenderuar të gjithë delegatët për besimin ndahu edhe njëherë me ta vizionin për sindikatën e së ardhmes dhe rrugën që kjo sindikatë duhet të ndjekë për tu fokusuar, rritur e për të shtrirë përfaqësimin e saj edhe në degë të tjera të sektorit të telekomunikacionit. Ai u zotua se projektin e nisur për ndryshimin dhe modernizimin e sindikatës do ta çoj edhe më përpara gjatë kësaj periudhe duke e bërë këtë sindikatë një shembull të sindikalizmit Shqiptar.



Kongresii 7-të i SPPTSH-së, me pjesëmarrjen e Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, z. Blendi Klosi dhe mesazhet e përcjella prej tij tërhoqi vëmendjen e të gjitha mediave dhe gjeti një pasqyrim të gjerë në të gjitha gazetatat dhe televizionet kombëtare.







KËSHILLI KOMBËTAR I SPPTSH

Në mbështetje të neneve 19 dhe 20 të Statutit të Sindikatës së Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar në datën 27 Maj 2017 në mjediset e hotel “Doro City” në Tiranë u zhvillua mbledhja e parë e Këshillit Kombëtar, pas zgjedhjes së tij në Kongresin e 7 (shtatë) të Sindikatës së Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar mbajtur më datë 10.02.2017 në Tiranë.

Mbledhjen e Këshillit Kombëtar e drejtoi Kryetari i Sindikatës z. **Renato Mucaj**. Mbledhja filloi me përshëndetjen e Kryetarit. Në vijim u bë prezantimi i të gjithë anëtarëve të këshillit kombëtar. Kryetari theksoi se është nevojë parësore që cdo anëtar i këshillit të ketë njohje të plotë të statutit të sindikatës për këtë qëllim u shpërnda dhe libri manual i statutit të Sindikatës.

Më pas mbledhja vijoi me rendin e ditës si më poshtë:

- 1) Informacion i Përgjithshëm për aktivitetin e Sindikatës për 6 Mujorin e I-rë, 2017*
- 2) Miratimi i Strukturës së re organizative*
- 3) Miratimi i Organeve Drejtuese dhe përfaqësuesve sipas strukturës së re.*
- 4) Raporti i Anëtarësimeve, Financiar dhe Projekt Buxheti i vitit 2017*
- 5) Vizioni dhe Plani Strategjik 2017 – 2022.*
- 6) Diskutim i lirë mbi problematika të tjera.*

Fillimi i 6 mujorit kishte në qendër të veprimtarisë Kongresin e 7-të të sindikatës, i cili pati një sukses të vecantë. Pjesëmarrja e Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë z. Blendi Klosi, zv Ministres znj. Vjollca Braho, të përfaqësuesve të tjerë të kësaj ministrie dhe të institucioneve të tjera shtetërore gjeti një pasqyrim të gjere ne media. Pjesëmarrja e përfaqësuesve më të lartë të qeverisë tregon edhe njëherë vlerësimin për seriozitetin dhe punën e sindikates sonë. Z. Klosi zgjodhi pikërisht Kongresin e 7-të të sindikatës sonë që t'i komunikonte të gjithë opinionit publik vendimin e qeverisë për rritjen e pagës minimale. Në kongres kishte një përfaqësi nga të gjitha sindikatat partnere si UniGlobal, Verdi, AFLCIO, Haber-Is, Sindikata Greke, Sindikata e Kosovës etj. Një vlerësim të lartë për zhvillimin e dialogut social shprehën edhe përfaqësuesit nga të dy kompanitë.

Kryetari informoi këshillin për situatën e kontratave kolektive dhe përpjekjet që janë bërë për përmirësimin e tyre gjatë procesit të negociatave. Gjithashtu u ndal te Posta Shqiptare, ku po bëhen përpjekje për të hyr në negociata ne lidhje me firmosjen e kontratës kolektive që na është mohuar me pa të drejtë si pasojë e influencës politike që ky institucion ka pasur në vitin 2015. Gjithashtu ai informoi këshillin edhe për takimin me Drejtorin e Përgjithshëm të ri të Albletecom,ku u diskutuan shumë çështje esenciale për punonjësit.

Një pikë tjetër ishte edhe cështja e edukimit të anëtarësisë në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman FES po zhvillohen një seri trajnimesh në rajone të ndryshme, ku risia e të gjithë trajnimeve është se ato po zhvillohen me bazën sindikaliste.

Kryetari ju raportoi të gjithë anëtarëve edhe për aktivitetin e sindikatës me partnerët ndërkombëtar si dhe për angazhimin tonë në Aleancën OUT formuar nga federata ndërkombëtare Uni Global Union, e cila ka ndërmarr iniciativën për nënshkrimin e një kontrate globale me Deutsche Telekom (DT). Për të arritur këtë objektiv është formuar projekti që parashikon ngritjen e sindikatës në DT Albania. Është zhvilluar një takim me kryesinë e DT-Albania në Shqipëri ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të sindikatave ndërkombëtare. Në kuadër të këtyre përpjekjeve me ndihmën e Fondacionit Gjerman FES Office Tirana, grupi drejtues i këtij projekti ka zhvilluar një program trajnimi në Berlin, Gjermani në zyrat e sindikatës Gjermane Ver.di.

Në përfundim të këtij programi është arritur të biem dakord me Ver.di-n që partneriteti ynë të vazhdoj dhe të ndërmarrim aktivitete të përbashkëta për të organizuar Sindikatën në DT-Albania.


Gjithashtu u prezantuan edhe trajnimet në vazhdim, ku më 17-18 Qershor me temë: “Forcimi i Sindikatës” do të zhvillohet trajnim me rajonin e Durrësit mbështetur nga fondacioni Gjerman dhe më 1-2 Korrik me temë “Kontrata Kolektive” (12 persona) – do të zhvillohet trajnim në Tiranë me Qendrën e Solidaritetit të Konfederatës Amerikane në të cilën do të ketë edhe pjesëmarrje nga kolegët e sindikatës së Kosovës.





Në vijim të pikës dy dhe tre të rendit të ditës, Kryetari i Sindikatës i paraqiti për propozim Këshillit Kombëtar strukturën e re organizative. Mbas diskutimeve mbi të gjitha ndryshimet dhe propozimet për emërimet sipas kësaj strukture, ajo u votua dhe miratua nga të gjithë anëtarët e Këshillit Kombëtar të SPPTSH-së. Në pozicionin e zëvendës kryetarit u zgjodh z. Zenel Muca.

Në pozicionin e sekretarit organizativ u zgjodh Znj. Andiola Dhëmbi. Në vijim të rendit të ditës Këshilli Kombëtar miratoi raportin e anëtarësisë, raportin financiar 2016, projekt buxhetin e 2017, të cilat u miratuan nga të gjithë anëtarët e Këshillit Kombëtar.



Në kuadër të hartimit të objektivave të reja të sindikatës, u paraqit nga kryetari vizioni dhe strategjia e sindikatës për vitet 2017-2022. Ku fokusi kryesor do të jetë tek:

- Rritja e kapaciteteve profesionale
- Forcimi i organizimit të brendshëm dhe kanaleve të komunikimit brenda organizatës
- Rritja e numrit të anëtarëve.
- Rritja sektoriale dhe përrthithja e sindikatave të reja
- Edukimi i anëtarësisë dhe aplikimi i eksperiencës ndërkombëtare.
- Mbledhje periodike për të dëgjuar kërkesat e shqetësimet e anëtarëve
- Benefite të ndryshme për anëtarët.

Në vazhdim u vendos që motoja e sindikatës në cdo fushatë të jetë **“Një sindikatë për të gjithë”**.

PËRFITIME TE REJA PËR ANËTARËT E SINDIKATËS SONË

Të dashur anëtarë,

Sindikata jonë në bashkëpunim me bizneset e mëposhtme ka menduar që këtë vit t'u ofrojë anëtarëve të saj mundësinë për të përfituar ulje në disa shërbime. Në vijim të politikave tona për ta kthyer këtë sindikatë në funksion të anëtarëve, kemi vendosur që **cdo anëtarë i SPPTSH mund të sjellë deri në 2 të njohur apo familjarë** të interesuar. Këta të fundit do të përfitojnë të njëjtat shërbime (familjarët apo të afërmit nuk mund të jenë punonjës të Altelecom/Makthes -jo anëtarë të sindikatës). Më poshtë ndodhet lista e shërbimeve dhe përfitimet përkatëse për anëtarët e sindikatës:

1. Klinika Dentare "Xholi"- SPPTSH Klinika dentare "Xholi" me të dy pikat e saj ofron **20 % ulje** në shërbime dentare për të gjithë anëtarët e sindikatës. Dr. Naim Xholi dhe Dr. Florian Xholi do t'ju mirëpresin në të dy klinikat dentare: Klinika Dentare "Xholi" 1- Vendodhja: Rruga e Kavajës, Mbrapa Poliklinikës nr. 9 Cel : 067 20 11 537. Klinika Dentare "Xholi" 2 - Vendodhja: Unaza e Re, Përbalë karburant Kastriotit, Rrethrotullimi pallatit Ales, Kati II. Cel: 067 20 11 538.

2. Qendër estetike "Flora"- SPPTSH ofron ulje 20-35% per anëtarët femra të sindikatës në shërbime të ndryshme estetike. Estetistja znj. Flora Doda me një eksperiencë 20 vjecare në fushën e estetikës do t'ju mirëpres në: Qendër estetike "Flora"-Vendodhja: Mbrapa ish ekspozitës " Shqipëria Sot".Kati I. Cel: 069 51 12 713.

3. Palestra 24 orëshe "Fit-Express" – SPPTSH Fit Express Tirana është një franchising Italian, i cili ka hapur fillialin për herë të parë në Tiranë. Një palester moderne, me shërbim 24 orë në 7 ditë të javës. Me një hapësirë prej afro 1000 m² dhe me të gjitha pajisjet e fjalës së fundit të Technogym, vjen më pranë jush për përkujdesjen fizike të trupit tuaj.

Të përfshira në cmim:

- Kurse në grup pa limit (CrossFit, Body Balance, Fitbox, Zumba, Kangoo Jumps, Step, Total Body, Ginastica Dolce, Poëer Pump, Ab Blaster, Yoga etj)
- Llampa nxirëse pa limit (Solar)
- Pije energjike pa limit
- Platforma me dridhje pa limit
- Sauna

Për të gjithë anëtarët e SPPTSH, kompania FitExpress ofron:

1. Abonim 1 vjecar me vlerë 2990 lekë/muaj.
2. Një orë Personal Trainer falas në rast abonimi.
3. Tre muaj falas për secilin abonim vjetor pasi të bëhen 100 abonime nga anëtarët e SPPTSH.
4. Një ditë prove falas. Kështu në dispozicion anëtarët e SPPTSH kanë 16 muaj duke konsideruar edhe muajin e pushimeve që mund të ndalojnë abonimin për 1 muaj.

Palestra "Fit Express"

Vendodhja: Ring Center, Kati i IV ,
Rrethrotullimi i Zogut të Zi. Cel: 069 87 44 444



Si do të funksionoj?

Këto shërbime do të ofrohen për të gjithë anëtarët duke filluar nga data **18.12.2017**. Të gjithë anëtarët që dëshirojnë të sjellin familjar dhe të afërm mund të dërgojnë dy emrat e tyre pranë sekretariatit organizativ të SPPTSH- andiola.dhembial@altelecom.al ose sindikata1991@gmail.com **deri në fund të muajit Dhjetor**. Mbas kësaj date çdo i interesuar është i lutur të na kontaktoj, që të përfshihet në muajt pasardhës.

Në të gjithë pikat e shërbimit anëtarët dhe familjarët e tyre duhet të paraqiten në emër të Sindikatës së Punonjësve të Postë Telekomit Shqiptar që të përfitojnë uljet e parashikuara.

PARTNERITETI SPPTSH-VER.DI

Një zhvillim i rëndësishëm për sindikatën tonë këtë vit ka qenë partneriteti që ka nisur me sindikatën Gjermane Ver.di, e cila është një nga sindikatat më të mëdha në Europë ku aderojnë 2 milion anëtarë. Ver.di është duke asistuar sindikatën tonë në kuadër të aleancës të Deutsche Telekomit OTU (One Telekom Union) për organizimin e sindikatës në Telekom Albania. Ky bashkëpunim ka sjellë takime reciproke, ku është hartuar një protokoll pune për të përcaktuar qartë angazhimin e secilës palë në këtë partneritet strategjik.

Për të arritur këtë objektiv Sindikata e Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar, në datat 15-19 Maj 2017 ka zhvilluar një vizitë pune pranë sindikates Gjermane Ver.di e mbështetur dhe financuar nga Fondacioni Gjerman FES. Synimi i vizitës përveç programit të trajnimit dhe shkëmbimit të eksperiencave, ka qenë dhe formimi i një partneriteti midis dy sindikatave dhe marrja e mbështetjes edhe nga zyra qendrore e fondacionit gjerman në Berlin. Prandaj takimi i parë është zhvilluar në zyrat e FES me z. Jorg Bergsterman – Koordinatorin e programeve në FES Gjermani. Në takim përveç delegacionit nga Shqipëria merrnin pjesë edhe Ado Wilhelm (Ver.di), Kornelia Dubble (Ver.di), Alke Boessiger (përfaqësuese e Uni Global), Mike Doding (Ver.di), Genci Lamllari (FES Tirana)

Në këtë takim u fol për bashkëpunimin midis SPPTSH –UNI Global – Ver.di –FES Tirana, ku u prezantua iniciativa e Deutsche Telekom Alliance dhe u vendos formimi i një strategjie të përbashkët në funksion të organizimit të DT në Shqipëri. Z. Bergsterman theksoi vazhdimin e bashkëpunimit me SPPTSH dhe se është në dijeni të vështirësive që paraqiten në këtë përpjekje të organizimit të sindikatës në DT Albania.

Në takim u fol edhe për çështje të rëndësishme të sektorit, të tilla si: “Work in the future-dixhitalizimi dhe sfidat e saj”, “Histori suksesi për transformimin e sindikatave”, “Marrëdhëniet ligjore dhe të dialogu social në Shqipëri”. Të gjitha palët ranë dakord në përfundimin se bashkëpunimi dhe partneriteti në nivel ndërkombëtar ka nevojë për funksionimin e përfaqësive në nivel vendor, ndaj është i nevojshëm kontakti dhe suporti i vazhdueshëm me përfaqësinë e FES në Shqipëri.



Kryetari i SPPTSH-së z. Mucaj në fjalimin e tij përmbyllës u shpreh se “përgjegjësia bie mbi ne, kështu që ne do të vazhdojmë të luftojmë që të zgjidhim problemet që kemi dhe të arrijmë atje ku duam. Por gjithashtu jemi më të motivuar kur mbështetemi dhe kemi përkrahjen tuaj.”

Gjatë ditëve në vazhdim delegacioni shqiptar zhvilloi një program trajnimi me specialist të sindikatës si Mike Doding, Andresa Franke, Martha Richards etj. në zyrat qendrore të Ver.dit në Berlin. Delegacioni i SPPTSH u trajnua për mënyrën e organizimit të strukturave të një sindikate, duke u paraqitur me shembuj praktike nga sindikata gjermane Ver.di. Të gjithë të pranishmit gjatë programit diskutuan fenomene që kanë zaptuar fushën e telekomunikacionit, ku më kryesoret është ulja e numrit të punonjësve të institucioneve dhe rritja e numrit të punonjësve të nënkontraktorëve. Tema të tjera trajnimi ishin rreth : eksperiencave të organizimit të T-Mobile në Amerikë, planifikimi i fushatave të anëtarësisë, përthithja e anëtarëve të rinj, përfshirja dhe angazhimi i anëtarëve të rinj, ruajtja e anëtarëve, Media dhe PR.

Një takim i veçantë ishte rezervuar edhe me konfederatën gjermane DGB. Përfaqësuesit më të lartë të kësaj konfederate Michael Wagner, Rainald Thannisch, Michael Bolte, Susanne Wixforth trajtuan disa tema interesante mbi rolin e sindikatave dhe konfederatave për bashkëpunimin e ngritjen e këshillave të punës në Shqipëri. DGB duke sjell shembullin gjerman theksoi se qëllimi kryesor i këtyre strukturave duhet të jetë unifikimi i politikave të sindikatave që bëjnë pjesë në të. Ata u shprehën se në Gjermani janë zëri i interesave të punonjësve dhe i transmetojnë kërkesat e sindikatave deri në parlamentin Europian. Ata shprehën mbështetjen e tyre për sindikatën e SPPTSH dhe hapën rrugët për bashkëpunim të mëtejshëm.

Një takim i veçantë është zhvilluar edhe me z. Lothar Schroder, Kryetar i Seksionit të Telekomit dhe IT në Ver.di dhe njëkohësisht zëvendës kryetar i bordit mbikëqyrës i Grupit Deutsche Telekom. Z. Schroder bëri një panoramë të planeve të DT, përvec të tjerash ai shpjegoi edhe si funksiononte bordi mbikëqyrës në Gjermani, ku punëdhënësit dhe punëmarrësit janë të përfaqësuar 50% me 50%. Kryetari i bordit është përherë përfaqësues i punëdhënësit dhe vota e tij ka peshën e dy votave ndërsa zëvendës kryetari vjen gjithmonë nga rradhët e punëmarrësve. Funksionet kryesore të këshillit janë: politikat e kompanisë, buxheti dhe rekrutimi i stafit menaxherial. Përfaqësuesit e punëmarrësve nuk kanë shumicë votash, por klima ka tendencën të jetë miqësore ndaj tyre. Bordet kanë një rend dite të caktuar edhe pse tema tabu është gjithmonë çështja e pagave. Përfaqësia e punëmarrësve në këtë bord është e zgjedhur dhe e votuar nga punëmarrësit.

56% e të punësuarëve në Grupin DT janë jashtë Gjermanisë nga të cilët pjesa më e madhe e tyre është në Amerikë. Detyra jonë, - theksoi z. Schroder, është nxitja e menaxhimit për të eksploruar ato fusha që premtojnë punësim dhe profesionalizëm tek punëmarrësit. Në përfundim të takimit z. Schroder shprehu solidaritet dhe mbështetje për nismën e SPPTSH-së. Gjithashtu ai tha se ishte i gatshëm të vij në Shqipëri për mbështetje të mëtejshme nëse sindikata jonë do të ketë barriera gjatë organizimit.

Në përfundim të këtij programi trajnimi e takimesh, është arritur të dakortësohet një partneritet afatgjatë midis sindikatës Gjermane Ver.di dhe Sindikatës së Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar. Ky partneritet do të jetë i koordinuar nga sindikata gjermane dhe do të ndërmarr aktivitete të përbashkëta për të organizuar Sindikatën në DT-Albania. Në këtë takim u vendos që detajet e këtij partneriteti të detajohen në takimin e Tiranës në Nëntor 2017.



Në datat 17-18 Nëntor është mbajtur takimi strategjik i bashkëpunimit midis Sindikatës së Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar (SPPTSH) dhe sindikatës gjermane VER.DI. në kuadër të aleancës OTU (One Telekom Union) ndërmjetësuar nga federata ndërkombëtare UniGlobal Union dhe mbështetur nga fondacioni gjerman Friedrich Ebert Stiftung (FES -Tirane). Qëllimi i këtij takimi ishte hartimi i një plani strategjik veprimi për organizimin e Sindikatës në Telekom Albania dhe rritjen e bashkëpunimit midis sindikatave tona për të konkretizuar organizimin e punonjësve.

Në këtë takim të rëndësishëm për herë të parë merrte pjesë edhe Drejtoresha e Departamentit të ICTS të UniGlobal Union znj. Alke Boessiger, ndërsa nga sindikata gjermane Ver.di merrte pjesë z. Ado Wilhelm, Mike Doding dhe Kornelia Dubbel. Gjithashtu në takim merrte pjesë edhe përfaqësuesi i fondacionit Friedrich Ebert Stiftung z. Genci Lamllari. Takimi dy ditor i mbajtur në Tiranë u zhvillua në vazhdim të takimit të parë gjatë muajit Maj (2017) në Berlin ku ishte përcaktuar edhe axhenda e protokollit mbi të cilën do të diskutohej në takimin strategjik në Tiranë. Përfaqësuesit e SPPTSH-së kryesuar nga kryetari z. Renato Mucaj shprehën edhe njëherë vendosmërinë e tyre për të kontribuar si pjesë e aleancës OTU në organizimin e punonjësve të Telekom Albania në sindikatë, të cilët janë të vetmit pjesë e grupit të Deutsche Telekomit në Europë që nuk kanë një organizim sindikal.

Të gjithë përfaqësuesit e SPPTSH-së që merrnin pjesë në këtë takim kanë zhvilluar një dialog konstruktiv duke gjeneruar ide të ndryshme që u bënë pjesë e protokollit të këtij plan veprimi. Në mënyrë vullnetare të gjithë pjesëmarrësit morën përsipër detyra të veçanta si pjesë e grupeve të punës që u ngritën gjatë këtij takimi për realizimin e planit të veprimit. Në vazhdim të partneritetit që u dakortësua në Berlin, Sindikata Gjermane u shpreh e gatshme për të aplikuar të njëjtën formë partneriteti që i jepet edhe Sindikatës Amerikane të Komunikimit (CWA) e cila po bënë një betejë të gjatë prej vitesh për organizimin e punonjësve të Deutsche Telekom në Amerikë.



Përfaqësuesja e sektorit të telekomit në federatën ndërkombëtare UniGlobal Union shprehu kënaqësinë e saj që për herë të parë vizitonte vendin tonë edhe sindikatën e Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar. Znj. Boessiger u shpreh se ndihet e kënaqur me produktet e nxjerra gjatë takimit dy ditor në Tiranë dhe priste me padurim rezultatet e planit strategjik të veprimit. Ajo theksoi se 'UniGlobal Union do të vazhdoj të mbështesë sindikatën tuaj në rrugën e forcimit dhe zgjerimit'. Gjithashtu nga ana e drejtoreshës së UniGlobal Union u vlerësua puna e bërë deri më tani dhe u deklarua se UniGlobal Union ka filluar studimin e tregut të Call Center për kushtet e punës në këtë sektor, i cili ka një numër të lartë të punësuarish dhe ku të drejtat e punonjësve shkelen në mënyra të ndryshme. Në përfundim të studimit të tregut, do të shikohet mundësia e bashkëpunimit me SPPTSH edhe për këtë sektor.



Z. Ado Wilhelm, përfaqësuesi i sindikatës gjermane Ver.di, i cili drejtoi dhe koordinoi takimin dy ditor në Tiranë, në fund të takimit u shpreh se ishte i lumtur për angazhimin konkret të përfaqësuesve të SPPTSH-së dhe se tashmë kërkohet nga të gjithë këta përfaqësues të çojnë përpara detyrat e dala nga ky plan strategjik veprimi. Këtë plan z. Eilhelm e vlerësoi si një punë cilësore në funksion të qëllimit të Aleancës OTU. Në përfundim të takimit të gjithë përfaqësuesit e SPPTSH-së dhanë mendimet e tyre për takimin, ku u vlerësua ndihma e madhe që sindikata Gjermane Ver.di po i jep sindikatës sonë SPPTSH. Kryetari i SPPTSH-së në fjalën e tij përmbyllëse falenderoi të gjithë pjesëmarrësit nga UNI, Ver.di dhe Fondacionin FES për mbështetjen që i japin lëvizjes sindikale në Shqipëri dhe kudo në botë ku ky fondacion operon. Z. Mucaj vlerësoi edhe njëherë takimin dhe i garantoi të gjithë pjesëmarrësit se SPPTSH do të vazhdoj të mbështesë Aleancën OTU dhe do të kontribuoj në mënyrë që askujt nga punonjësve të sektorit të telekomunikacionit mos ti mohohet e drejta kushtetuese e organizimit në sindikatë.



MINISTRIA E PUNËS, KËSHILLI KOMBËTAR I PUNËS DHE PARTNERËT SOCIALË

Riformatimi i ri i ministrive dhe mbetja pa emër e Ministrisë së Punës, të lë një shije për të mos thënë një mendim paksa të çuditshëm: Kjo Ministria e Punës nuk paskësh pas aspak rëndësi për qeverinë, apo nuk ka kryer asnjë funksion? Një godinë e madhe në mes të qendrës së Tiranës me plot kate e zyra, me plot drejtorë e specialistë që pas fitores së demokracisë po punonte për të rregulluar marrëdhëniet e punës, funksionimin institucional të dialogut social midis partnerëve punëmarrës (sindikatave), punëdhënës (Shoqatat e punëdhënësve) dhe përfaqësuesve të qeverisë (shtatë ministra), që përbënin Këshillin Kombëtar të Punës, do të jetë një karakoll, që do të mbulojë nevojat për mjedise të ministrive të tjera?!

Pyes me shqetësim: Deri kur qeveria nuk do të konsultohet me partnerët e interesuar për këto ndryshime rrënjësore, strukturore, që prekin interesat e tyre? Vallë kjo Ministria e Punës paskësh qenë kot? Nuk janë bërë ende dy vite që Kuvendi i Shqipërisë miratoi ndryshimet e fundit në Kodin e Punës dhe tashmë shumë nene të këtij Kodi dalin të pavlera.

Po si po reagojnë partnerët socialë? Një hutim total, një çoroditje i ka pështjellë si sindikatat, ashtu edhe punëdhënësit, që po presin çfarë do të ndodhë, me kë do të komunikojnë, kush do të jetë ministria, që do të luaj rolën e interlokutorit me ministrinë e tjera me të cilët ata do të kenë probleme për të diskutuar apo për të zgjidhur. U fol që Ministria e Financës dhe e Ekonomisë do të mbulonte edhe misionin e Ministrisë së Punës, por pastaj u katandis kokoshi një thele dhe një çikërrimë iu la Ministrisë së Shëndetësisë që do të shohë edhe mbrojtjen sociale. Pak paradoksale kjo, sepse nuk arrij të kuptoj se ç'lidhje ka Ministria e Shëndetësisë me mbrojtjen sociale, sikur nuk ma gjen mendja. Mirë kjo është puna e qeverisë, por ju lutem si do të justifikohet dhe si do t'u shpjegohet donatorëve të ndryshëm e sidomos Bashkimit Europian, që kanë shpenzuar goxha fonde për të trajnuar partnerët socialë dhe drejtorinë e punonjësit të Ministrisë së Punës, apo anëtarët e Këshillit Kombëtar të Punës, që asnjë herë nuk u respektua për misionin që kishte dhe konsulentat e tij kjo qeveri nuk i zbatoi në shumicën e rasteve, ndonëse ky ishte institucioni më i lartë i dialogut trepalësh social.

Janë ngritur soj - soj këshillash nga qeveria, por sindikata që përfaqëson punëtorët nuk është në asnjërin prej tyre. Qeveria e ka parë me vend që të jetë shoqëria civile dhe tani gradualisht ajo e mbylli hermetikisht dialogun me sindikatat e punëtorëve, pasi edhe Këshilli Kombëtar i Punës është drejt fundit të funksionimit të tij. Pavarësisht se si kanë funksionuar, sa rëndësi u kanë dhënë atyre, sa eficiente kanë qenë, apo sa probleme kanë zgjidhur ose sa fasadë kanë paraqitur me performancat e tyre në televizion, përsëri një gjë që është mund të rregullohet, reformohet, apo evoluohet, por kur nuk ekziston fare atëherë për fatin e keq, pasi u deklarua që në Shqipëri nuk ka sindikata tani zhduken edhe institucionet si ai i dialogut tripalësh dhe qeveria e konfirmon plotësisht atë që ka shprehur dhe që nuk i bën nder, pasi shkel rëndë demokracinë në vendin tonë. Po kur do të dalin nga çoroditja partnerët socialë? Kur ata di t'ia bëjnë të qartë qeverisë që ajo duhet të shpallë dhe t'i bëjë publikë planet e saj lidhur me këto shqetësime që janë edhe probleme shumë serioze.

Kjo amulli e krijuar çon ujë në mullirin, që krijon një situatë të rrezikshme e cila me pak fjalë nënkupton që edhe nëse do të bëhet diçka është një arnë që nuk e mbulon lakuriqësinë dhe ata që e pësojnë janë punëtorët, janë sindikatat e tyre ndaj të cilave po bëhet një presion i jashtzakonshëm për të penguar funksionimin dhe misionin e tyre të avokatisë së punëtorëve, të pensionistëve dhe të shtresave në nevojë. Po me Kodin e Punës, me fondet, që u shpenzuan, me përpjekjet njerëzore për të bërë një Kod të mirë të standardeve europiane çfarë do të bëhet, apo jemi mësuar ne shqiptarët pasi i shtrojmë bulevardet kujtohemi që nuk kemi bërë kanalizimet dhe harxhojmë para nga e para për të rishtruar pllakat e bulevardeve apo trotuareve, sepse dhe tani i ka ardhur radha që Kodi i Punës t'i përshtatet riorganizimit të ministrive dhe mosekzistencës së Ministrisë së Punës që është determinantja që i referohet ky Kod apo Këshillit Kombëtar të Punës që zë një vend të rëndësishëm në të.

Partitë politike kanë misionet e tyre një ndër të cilët është edhe mbështetja e sindikatave, por këtë e bëjnë vetëm në kohë fushate, kur i duhet mbështetja e sindikatës. Nuk kam dëgjuar asnjë prononcim të asnjë politikani të asnjë krahu të shfaqë sadopak shqetësim për këtë problem serioz, madje as Presidentit të Republikës, që ka qenë edhe kryeministër dikur, nuk i ra ndërmend që u eliminua Ministria e Punës, hallka që ishte më pranë qoftë edhe teorikisht me punëtorët jo vetëm për nga emri, por edhe nga misioni që kishte ose duhej të kryente. Nuk e di të shpresojm që partnerët socialë të reagojnë, sindikatat më fort se kushdo dhe qeveria të paraqesë platformën se çdo të bëjë për të mbuluar këtë të grisur të madhe që s'ka arnë që ta mbulojë.

HIQMETE DAJA

Presidente e Sindikatës së Pavarur të Tipografisë së Shqipërisë

FORMIMI I SË ARDHMES, HAPJA E PERSPEKTIVAVE TË REJA, MARRJA E PËRGJEGJËSISË.



Në reagim ndaj themelimit të One Telekom Europe, një vendim fillestar u ndërmor në vitin 2016 në Budapest për të krijuar dhe institucionalizuar një aleancë sindikale- "One Telekom Union" - i cili bashkon të gjitha sindikatat e përfaqësuar në Grupin European Telekom nën ombrellën e UNI, si dhe Deutsche Telekom EWC (KEP-Këshilli European i Punëtorëve të Deutsche Telekom). Takimi i mbajtur në tetor 2017 në Malin e Zi është një arritje e mëtejshme në rrugën drejt një aleance të fortë sindikale. Deutsche Telekom Group AG po bëhet gjithnjë e më globale. Kjo vlen edhe për organet e saj vendimmarrëse dhe për bartjen e përgjegjësisë. Industria e telekomunikacionit është në prag të një konsolidimi masiv global i cili do të ketë një ndikim serioz në Telcos Evropiane në përgjithësi, dhe Deutsche Telekom në veçanti. Ndryshimet teknike, masat organizative dhe ndikimi i tyre në jetën e njerëzve nuk ndalen në kufijtë kombëtarë.

Është e domosdoshme që të gjithë ata që kanë përgjegjësi për të mbrojtur interesat e punëtorëve (UNI, Sindikatat, këshillat e punës, KEP) e kuptojnë rëndësinë e rritjes së bashkëpunimit dhe zhvillimit të rrjeteve. Kjo është diçka që duhet ndjekur pa hequr dorë. Në Budapest u ra dakord për një sërë objektivash të përbashkëta. Këto përfshinin:

- *Të përfshihemi në të gjitha vendimet e marra nga One Telekom Europe*
- *Zhvillimi i strategjive të përbashkëta për të mbrojtur interesat e punëtorëve*
- *Miratimi i një qasjeje të koordinuar*
- *Shkëmbimi i informacionit në baza të rregullta*
- *Të kërkojë të ndikojë në rregulloret evropiane që ndikojnë në tregjet e telekomit*
- *Përdorimi më i mirë i KEP-së për të zgjeruar të drejtat e punëtorëve*

Këto parime u rikonfirmuan në Malin e Zi. U ra dakord gjithashtu që interesat e pastra kombëtare duhen lënë mënjanë dhe të gjitha përpjekjet janë të fokusuar në zbatimin dhe avancimin e këtyre shkaqeve si çështje urgjente. Kompanitë globale kanë nevojë për përgjigje të sindikatave globale dhe veprime të sindikatave globale që nxisin solidaritetin. "One Telekom Union" është përgjigja dhe baza për unitetin tonë të veprimit dhe solidaritetit. Në Budapest aleanca ra dakord që solidariteti dhe bashkëpunimi midis sindikatave, këshillave të punës, Këshillit të Punës Evropiane dhe përfaqësuesve të punonjësve në bordet mbikëqyrëse të kompanive kombëtare duhet të thellohet, zgjerohet dhe optimizohet. Një nga objektivat tona kryesore është shfrytëzimi i të gjitha mundësive dhe levave që ekzistojnë në shtete të ndryshme për të zgjeruar të drejtat dhe mundësitë e KPE-së për të bërë punën e tyre. Ky është një nga aspektet kyçe të detyrës që shtrihet përpara. Për të arritur këtë qëllim, Grupi Drejtues ka hartuar një plan. Aleanca vëren se përballja me transformimin e aktiviteteve të DTAG, si dhe konsolidimi i afërt i industrisë së telekomunikacionit, solidariteti dhe mbështetja e ndërsjellë duhet të jetë bazë për mbrojtjen dhe sigurinë e punonjësve në filialet kombëtare që janë pjesë e rrjetit evropian të Telekomit.

Diskutimet me menaxhmentin e Grupit dhe vendimmarrësit në filialet kombëtare janë një hap në drejtimin e duhur. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të menaxhmentit në takimin e Malit të Zi, që është kontakti i tyre i parë me Grupin Drejtues të OTU, është një zhvillim që ne mirëpresim.

Ne besojmë se kjo paraqet një lëvizje pozitive drejt një dialogu konstruktiv dhe pragmatik. Pjesëmarrësit në takim në Mal të Zi theksojnë me kënaqësi të madhe se prania e Dr Illek, anëtar i Bordit për Burimet Njerëzore në DTAG, do të thotë që ne mund të fillojmë një debat substancial mbi disa çështje madhore. Kjo shpresë së shpejti do të pasohet nga mundësi të tjera për diskutime të thella. Çështje të mëtejshme që duhet të ngrihen duhet të identifikohen dhe të trajtohen së bashku. Çështja e PanNet është një çështje e tillë që OTU beson se duhet të jetë subjekt i diskutimeve të gjera si çështje urgjente. Anëtarët e Aleancës pajtohen që bashkëpunimi në mes të OTU dhe Grupit duhet të përqendrohet në çështjet e politikave të gjera dhe nuk duhet të bjerë poshtë në çështje që janë me rëndësi të veçantë kombëtare.

Sindikatat pjesëmarrëse, UNI dhe KPE riafirmojnë marrëveshjen e arritur në Budapest për të zhvilluar masat e nevojshme në mënyrë konsensuale dhe për të punuar për t'i zbatuar ato menjëherë. Hapi i ardhshëm do të përfshijë vazhdimin dhe thellimin e dialogut me Grupin dhe filialet kombëtare. Drejtimi do të merret nga Grupi Drejtues i cili do të synojë të angazhojë DTAG dhe filialet kombëtare në një diskutim të thellë, i cili do të paraprihet nga identifikimi i çështjeve thelbësore si dhe sfidat e shkaktuara nga konsolidimi dhe zhvillimet në industri. Më konkretisht, lëndët do të përfshijnë:

- PanNet
- Iniciativat rregullatore
- Rritja e të drejtave dhe mundësive të ofruara për KPE
- Trajnimi i vazhdueshëm dhe i avancuar
- Arritja e një marrëveshjeje me Grupin dhe filialet kombëtare për të lejuar sindikatat të kryejnë aktivitetet e tyre lirisht dhe pa pengesa dhe qasja do të drejtohet për zgjidhjen e këtyre çështjeve.

Aleanca sindikale ofron një dialog të drejtë të frymëzuar nga një ndjenjë përgjegjësie dhe imagjinate politike. Nga ana tjetër, pret që shoqëria mëmë e DTAG dhe filialeve rajonale të vazhdojnë ta thellojnë diskutimin sa më parë që të jetë e mundur. Mirëqenia dhe zhvillimi i kompanisë dhe punonjësve të saj duhet t'u jepet një vlerë e barabartë dhe të gjitha vendimet që kompania synon të ndërmarri duhet të shqyrtohen për të siguruar që ata gjithashtu të marrin parasysh shqetësimet e punonjësve që kanë të drejtë të trajtohen me respekt, ndershmëri dhe t'u ofrohet një perspektivë për të ardhmen.

Podgoricë, 27 tetor 2017





SEMINAR “FORCIMI I STRUKTURAVE TË SINDIKATËS” SPPTSH – FES.

Në kuadër të strategjisë së re, janë zhvilluar një seri trajnimesh jo vetëm për përfaqësuesit e zgjedhur të sindikatës, por edhe për anëtarësinë në të gjitha seksionet dhe rajonet. Ky plan seminaresh i vitit 2017 ka qenë i ndarë në dy pjesë, ku pjesa e parë përfshinte të gjitha rajonet ndërsa pjesa e dytë vetëm seksionet e Tiranës.

Kjo seri seminaresh është mbështetur gjerësisht nga fondacioni gjerman Friedrich Ebert Stiftung (FES), pasi synimi ka qenë forcimi i sindikatës në bazë dhe identifikimi i problemeve në vendin e punës. Pjesa e parë e këtyre seminareve ka filluar me rajonin Shkodër-Lezhë, duke vazhduar me rradhë me rajonet, Kukës-Peshkopi, Korçë-Elbasan, Fier-Berat dhe Vlorë-Gjirokastrë. Tema e trajtuar gjatë këtyre seminareve ka qenë “Forcimi i Strukturave të Sindikates”. Lektorja znj. Hiqmete Daja ka zbërthyer dhe trajtuar disa aspekte që të gjithë anëtarët duhet të kenë parasysh kur janë pjesë e një sindikate, duke i ilustruar ato me shembuj të shumtë nga përvoja e saj sindikale. Gjatë seminarit është dhënë një informacion i detajuar mbi: partnerët që veprojnë në një sindikatë, vështërsitë e organizimit, kompetencat e sindikatës, faktorët në mirëfunksionimin e sindikatës, kontrata kolektive, anëtarësia e sindikatës, fuqia e saj dhe strategjitë e rekrutimit.





Në pjesën e dytë janë zhvilluar tre seminare me të gjitha seksionet e rajonit të Tiranës duke filluar me ALB 1(Teknika), ALB 6 (IT), MAK 2 (Teknika); ALB 4 (Administrata) ALB 5 (Financa) MAK 1 (Administrata) dhe ALB 2 (Shitje), ALB 3 (Marketingu). Në këto trajnime specialisti i marrëdhënieve të punës av. Ledio Milkani dha informacion në lidhje me Kodin e Punës, ndryshimet, nenet esenciale që prekin marrëdhëniet e punës, kontratën kolektive, sindikatat dhe organizimin e institucioneve të punës në Shqipëri.

Në pjesën e dytë të çdo trajnimi, pjesëmarrësit janë informuar nga Kryetari z. Renato Mucaj për aktivitetin e Sindikatës. Më pas të gjithë kanë pasur mundësi të diskutojnë mbi problematikat në vendin e tyre të punës. Të gjitha këto problematika të mbledhura i janë paraqitur drejtuesve të kompanive respektive. Kryetari i Sindikatës z. Renato Mucaj, ka theksuar edhe njëherë faktin së vetëm nëse jemi të bashkuar në Sindikatë mund të organizohemi më mirë për të mbrojtur të drejtat tona të përbashkëta.



SEMINAR “KONTRATA KOLEKTIVE” SPPTSH – FSP-PTK –SPTSH AFL-CIO

Në datat 1-2 Korrik 2017, Sindikata e Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar ka zhvilluar në Tiranë në bashkëpunim me Qendrën e Solidaritetit të Konfederatës Amerikane AFL-CIO, një trajnim mbi Kontratën Kolektive dhe tryezën e bisedimeve. Në këtë trajnim ishin të ftuar edhe 4 përfaqësues nga Federata Sindikale e Pavarur e Postë Telekomit të Kosovës z.Lamih Balaj, z.Ajet Ahmeti, z.Shyqeri Musliu, z.Xhevdet Gjuka, dhe 2 përfaqësues të Sindikatës së Punonjësve të Tipografisë znj. Erinda Stafa dhe znj.Iva Kalemi. Përfaqësuesi i Qendrës së Solidaritetit z. Laurie Clements i cili ka drejtuar edhe trajnimin ka bërë një pasqyrë të procesit të negociatave kolektive - çfarë është projektuar për të bërë, si sindikata përdor kontratën kolektive për të arritur objektivat e saj, planifikimi i strategjisë së bisedimeve, vendosja e qëllimeve të negociatave, klasifikimi i propozimeve, gjuha e shkrimit të kontratës kolektive etj. Në pjesën e fundit të trajnimit të gjithë pjesëmarrësit janë ndarë në grupe dhe kanë kryer simulim negociatash ku njëra palë ka qënë punëdhënësi dhe pala tjetër ka qënë në rolin e grupit negociator të punëmarrësve.



SEMINAR SPPTSH – PRAKTIKA JURIDIKE – FES

Ditën e shtunë më datë 18 Mars 2017, me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert Stiftung Tiranë, në bashkëpunim me “Praktika Juridike” dhe nën kujdesin e kryetarit të SPPTSH z. Renato Mucaj, është zhvilluar një seminar për drejtuesit e sindikatës në Tiranë me temë “Mbi falimentimin , transferimin dhe ndarjen e ndërmarrjeve si dhe efektet mbi punonjësit”. Në këtë seminar merrnin pjesë drejtues së sindikatës së rajonit Tiranë, si nga kompania Albtelecom ashtu dhe nga kompania Makhes. Eksperti ligjor i “Praktika Juridike” z. Ledio Milkani diskutoi me pjesëmarrësit këto tema kaq aktuale me të cilat çdo organizatë punëmarrësish mund të përballë gjatë aktivitetit të saj. Z. Milkani dha këshilla shumë të vlefshme mbi ndryshimet ligjore dhe nenet që duhet të parashikohen në kontrata kolektive për të evituar fenomene të cilat mund të dëmtojnë punonjësit në rast falimentimi, transferimi ose ndarje ndërmarrjeje.



NJE KARTOLINE URIMI PËR PUNONJËSIT E TELEKOM ALBANIA



Në vijim të strategjisë së përcaktuar në takimin midis SPPTSH, Ver.di dhe UniGlobal Union për të konkretizuar organizimin e punonjësve të Telekom Albania në Sindikatë është ndërrmarë hapi i parë i planit të veprimit duke nisur me informimin e punonjësve për Sindikatën.

Për të konkretizuar këtë qëllim dhe në pamundësi për të ushtruar një komunikim të drejtëpërdrejtë me punonjësit është zgjedhur pikërisht data 21 Dhjetor 2017 kur kompania Telekom Albania kishte organizuar mbrëmjen e fundvitit në Hotel Rogner. **Sindikata e Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar ka shfrytëzuar këtë moment për të shpërndarë kartolinat për të gjithë punonjësit në hyrjen e hotelit ku ishte organizuar mbrëmja festive. Me anë të kësaj kartoline përfaqësuesit e sindikatës kanë dashur t'i urojnë punonjësve një vit të mbarë dhe t'ju kujtojnë se askush nuk mund t'ua mohoj të drejtën për tu organizuar në sindikatë.**

Përfaqësuesit e SPPTSH-së janë të vendosur si pjesë e aleancës OTU në organizimin e punonjësve të Telekom Albania në sindikatë, të cilët janë të vetmit pjesë e grupit të Deutsche Telekomit në Europë që nuk kanë një organizim sindikal. SPPTSH po vazhdon komunikimin me kompaninë në mënyrë që të bind drejtuesit e saj për të nisur një dialog social midis palëve dhe bashkarisht për të evindetuar nevojat e punonjësve.





TAKIME TË NDRYSHME NGA AKTIVITETETI SINDIKAL I SPPTSH-së GJATË VITIT 2017

SPPTSH NË “VIZION 2025 – SHQIPËRIA ËSHTË NJË VEND ANËTARË I BE-SË”

Me rastin e përfundimit të mandatit të Drejtorit aktual të Fondacionit Gjerman Friedrich Ebert Z. Frank Hantke dhe me emërimin e Drejtorit të ri Z. Ëulf Lapin, Fondacioni Friedrich Ebert organizoi më 27 Prill 2017, në mjediset e Hotel Rogner aktivitetin me temë “Vizion 2025 – Shqipëria është një vend anëtarë i BE-së”. Në këtë aktivitet ishin të ftuar shumë miq dhe bashkëpunëtor të Fondacionit Friedrich Ebert, ku ndër të tjera merre pjesë edhe Sindikata e Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar.



SPPTSH NË 27 VJETORIN E TIPOGRAFISË.

SPPTSH e ftuar nga Presidentja e Sindikatës së Pavarur të Tipografisë së Shqipërisë znj. Hiqmete Daja ka marrë pjesë me 7 delegatë në ceremoninë e 27 vjetorit të themelimit të SPTSH-së. Në këtë aktivitet ishin të ftuar përfaqësues, anëtarë, miq dhe sindikata partnere të Sindikatës së Pavarur të Tipografisë së Shqipërisë. Gjatë këtij aktiviteti u kujtuan dhe nderuan disa tipograf të vjetër të cilët ishin ndarë nga jeta. Më pas të gjithë të ftuarit kanë darkuar së bashku në darkën festive organizuar nga Sindikata e Pavarur e Tipografisë.

SPPTSH NË KONFERENCË “ORGANIZIMI I PUNONJËSVE TRANSNACIONAL”

Ndërtimi i sindikatave më të forta dhe organizimi i punonjësve ndërkufitar ka qenë tema e Konferencës së mbajtur në datat 6 - 8 Shtator 2017, në zyrat qendrore të fondacionit Gjerman Friedrich Ebert në Berlin. Gjatë kësaj konference janë zhvilluar shumë takime dhe diskutime mbi problemet që ka organizimi i kompanive të angazhuara në aktivitete dhe investime transnacionale. Krijimi i këtyre zinxhirëve të shpërndarjes nëpër vende dhe madje edhe nëpër kontinente, krijon një armë në dorë të punëdhënësve për të sulmuar fortesat tradicionale të Sindikatave. Në të njëjtën kohë ajo hap mundësitë për bashkëpunimin e sindikatave, pjesëmarrjen dhe organizimin ndërkombëtar të punëtorëve. Si pjesë e Aleancës Deutsche Telekom, në këtë konferencë me ftesë të Fondacionit Gjerman ka qenë i ftuar dhe kryetari i SPPTSH-së, i cili ka marrë pjesë në panelin e diskutimit të drejtuar nga koordinatori i programit të sindikatave z. Jörg Bergstermann. Në këtë panel diskutimi z. Mucaj ka informuar audiencën mbi vështirësitë që kanë hasur në organizimin e Telekom Albania dhe me punën e përbashkët që po bëhet me Aleancën dhe Sindikatën Gjermane Ver.di. Konferenca e përbashkët për “Organizimin e Punonjësve Transnacional” u mbështet nga IndustriAll Europe, UNI Europe, FES, ETUI dhe IG Metal.



SPPTSH

ANËTARE E RRJETIT BALCANOSH.NET

Rrjeti Ballkanik i Sigurisë e Shëndetit në Punë, BALcanOSH.net, zbatues i projektit IPA të Bashkimit Europian për “Rritjen e kapaciteteve dhe forcimin e rolit të Organizatave të Shoqërisë Civile rajonale, për përmirësimin e kushteve të punës dhe dialogut të punës me institucionet publike” ka zhvilluar një trajnim të fokusuar në standartet bazë të sigurisë dhe shëndetit në punë, lobim dhe avokim për kushtet e punës, përfaqësim dhe bashkëpunim midis institucioneve publike, sindikatave, organizatave të shoqërisë civile, organizatave të medias dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm, që operojnë në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë. Pjesë e këtij aktiviteti ka qenë edhe sindikata e punonjësve të postë-telekomit Shqiptar e përfaqësuar nga kryetari i saj z. Renato Mucaj.

Qëllimi i këtij aktiviteti organizuar nën kujdesin e zyrës lokale në Tiranë, AOSHC ishte njohja dhe vendosja e urave të komunikimit dhe bashkëpunimit midis aktorëve kryesor që operojnë në fushën e sigurisë e shëndetit në punë, për të lehtësuar shkëmbimin e ideve, njohurive dhe eksperiencave në nivel kombëtar dhe rajonal. Identifikimi i nevojave, mangësive dhe problemeve që hasen në përfshirjen e gjithë aktorëve për hartimin e politikave që rrisin partneritetin në vendim-marrje dhe inkurajojnë dialogun me institucionet publike. Prugët efikase për përmirësimin e tyre në nivel kombëtar dhe rajonal. Diskutim mbi mënyrat e rritjes së vetëdijes publike për rëndësinë e praktikave profesionale të sigurisë e shëndetit në punë dhe roli i medias në monitorimin dhe promovimin e tyre. Bashkëpunimi midis organizatave rajonale dhe mediave në rajonin IPA. PROGRAMI I TRAJNIMIT 3 ditor 14-16 Nëntor 2017 ishte i larmishëm, ku ndër temat kryesore të cilat u trajtuan ishin :



Projekti IPA - idetë, qëllimet, rezultatet dhe qëndrueshmëria;
Direktiva 89/391 /KEE Strategjia Europiane 2014 – 2020;
Bazat e SSHP (ligjet, VKM, rregulloret, organizimi, sistemet e menaxhimit të SSHP, të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësve dhe punonjësve, rrisqet dhe rreziqet në vendin e punës) - Legjislacioni kombëtar;

- Dialogu social – koncepti dhe praktika ;
- SSHP dhe Shoqëria Civile;
- Krijimi i një rrjeti të OSHC-ve dhe përmirësimi i tyre;
- Aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale(Investigimi dhe raportimi);
- Marëdhëniet me publikun / Mediat për Organizatat Qytetare (komunikimi - bashkëpunimi – partneriteti) ;
- Ndërtimi dhe forcimi i rrjeteve të OSHC-ve, lobimi dhe avokimi;
- Parimet kryesore për marëdhëniet me publikun dhe komunikimi i aktorëve;
- Bazat e planifikimit strategjik, lobimi dhe avokimi;
- Fushata e ndërgjegjësimit – “S’ka kohë për të humbur”;
- Fushata e ndërgjegjësimit – “Vende pune të shëndetshme për cdo moshë”;

Në këtë trajnim merrnin pjesë lektor të huaj dhe vendas Karoli Gregori - Ekspert ILO, Eda Beqiri-Eksperte, Entela Hysenllari, Mario Velkoviç - Expert, Bojan Kordalov, Malcolm McIntyre-Ekspert IOSH dhe Tim Dragesta - EU OSHA Expert.



SPPTSH NË KËSHILLIN KOMBËTAR TË PUNËS,

Këshilli Kombëtar i Punës zgjedh ambientet e kompanisë ALBtelecom për të zhvilluar mbledhjen e tij të radhës, të datës 17.02.2017. Në ambientet e kompanisë ALBtelecom është zhvilluar mbledhja e radhës e Këshillit Kombëtar të Punës, ku temë kryesore e saj ishte rritja e nivelit të pagës minimale në vend, duke filluar prej 1 Marsit 2017. Prej disa javësh Ministri i Mirëqenies Sociale kishte deklaruar se gjatë mbledhjes së radhës do të merrej një vendim i KKP-së, i cili kishte rënë dakord paraprakisht edhe me grupet e interesit. Këtë deklaratë Ministri z. Blendi Klosi e përsëriti edhe gjatë punimeve të Kongresit të SPPTSH në datën 10 Shkurt 2017. Gjatë mbledhjes së Këshillit Kombëtar të Punës ishte i ftuar dhe z. Renato Mucaj si pëfaqësues i SPPTSH-së.

DARKA IFTARIT NGA SINDIKATA

Sic është bërë një traditë tashmë Sindikata edhe këtë vit ka shtruar për të gjithë punonjësit besimtarë Darkën e Iftarit gjatë muajit të Shenjtë të Ramazanit, ku kanë qenë të ftuar të gjithë punonjësit e besimit mysliman. Darka është shtruar në ambientet e Kompleksit Taiwan te Restorant "Steak House".

AKTIVITET SOCIAL PËR ANËTARËT E SEKSIONIT MAKHES 2 NË TIRANË


Sindikata e Punonjësve të Post-Telekomit Shqiptar në vazhdim të aktiviteteve sociale për të rritur frymën kolektive të punonjësit, ka organizuar për anëtarët e Seksionit Makhes 2 në Tiranë dy darka festive në prag të festave të fundvitit. Rreth 90 teknik të Rajonit të Tiranës që kanë dhe detyrën më të vështirë të përballjes cdo ditë me mirëmbajtjen e abonentëve të kryeqytetit, janë grupuar me sektoret e tyre në dy darka paralele për të festuar mbylljen e vitit. Të gjithë teknikët kanë kaluar caste festive në të dy darkat dhe kanë falenderuar drejtuesit e sindikatës për këtë organizim. Duke falenderuar edhe njëherë të gjithë pjesëmarrësit e pranishëm po ndajmë me ju disa foto gjatë aktivitetit.



NË KËTË RRUGË TË VËSHTIRË
NJË FALENDERIM I VEÇANTË SHKON PËR TË
GJITHË PARTNERËT TANË !



ANËTARËSOHU TANI



Një Sindikatë për të gjithë

**TË GJITHË BASHKË PËR PAGA,
MIRËQENIE DHE STANDARTE
MË TË LARTA**